

Në bazë të nenit 35 dhe 36, të Ligjit për arsim të lartë (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, numër 82/2018) dhe nenit 71 dhe 72 të Statutit të Universitetit të Evropës Juglindore, Bordi i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 05.06.2020, e miratoi këtë:

## **STATUTI I PARLAMENTIT DHE ASOCIACIONIT STUDENTOR**

### **Organizimi i studentëve**

#### **Neni 1**

- (1) Parlamenti dhe Asociacioni Studentor (në vazhdim Parlamenti Studentor), është trup i Universitetit të Evropës Juglindore (në vazhdim Universiteti), në të cilin janë të anëtarësuar përfaqësues të studentëve.
- (2) Universiteti është i detyruar që Parlamentit Studentor, Avokatit të studentëve t’u sigurojnë hapësira për punë dhe t’u ofrojnë ndihmë teknike administrative.

### **Financimi**

#### **Neni 2**

- (1) Puna e Parlamentit Studentor financohet nga mjetet financiare të Universitetit, si dhe nga burime të tjera brenda kornizave buxhetore të Universitetit.
- (2) Parlamenti Studentor disponon me mjetet në mënyrën e përcaktuar me buxhetin e Universitetit.
- (3) Programi dhe buxheti vjetor miratohen nga ana e Parlamentit Studentor dhe autorizohet nga Bordi i Universitetit në bazë vjetore për vitin akademik aktual. Buxheti i Parlamentit Studentor mbikëqyret nga Universiteti. Parlamenti Studentor obligohet t’i raportojë Universitetit për buxhetin, në mënyrë të rregullt.

### **Parlamenti dhe Asociacioni Studentor (PAS)**

#### **Neni 3**

- (1) Parlamenti Studentor është trup i Universitetit në të cilin janë të anëtarësuar përfaqësuesit e studentëve.
- (2) Parlamentit Studentor i mbron interesat e studentëve, përmes pjesëtarëve të vet merr pjesë në vendimmarrje në organet dhe trupat e Universitetit dhe i prezanton studentët në suaza të arsimit të lartë si anëtarë të bashkësisë akademike.

### **Kompetencat**

#### **Neni 4**

- (1) Parlamenti Studentor ka kompetencë të:
  - zgjedh përfaqësues studentor në Senatin dhe organet dhe trupat tjerë të Universitetit;
  - miraton plan dhe program për punën e vet;
  - propozon avokat studentor;

- kujdeset për cilësinë e jetës së studentit dhe cilësinë e procesit të studimit, standardin studentor, realizimin e të drejtave dhe interesave studentore dhe për përsosje kulturore, sociale dhe intelektuale të studentëve;
  - organeve drejtuese, u propozon plan për financim të aktiviteteve studentore;
  - stimulon aktivitete studentore jashtë procesit të mësimdhënies;
  - kryen aktivitete tjera të interesit të studentëve.
- (2) Parlamenti Studentor përbëhet prej përfaqësuesve të studentëve të zgjedhur në zgjedhjet e rregullta të Parlamentit Studentor nga studentët e Universitetit.
- (3) Në Parlamentin Studentor anëtarësohen nga së paku dy përfaqësues të fakulteteve me mandat njëvjeçar dhe të drejtë edhe për një zgjedhje.
- (4) Kryetari i Parlamentit Studentor zgjidhet nga radhët e përfaqësuesve të studentëve në Parlament me mandat njëvjeçar dhe të drejtë edhe për një zgjedhje.
- (5) Parlamenti Studentor siguron një qasje shumë-gjuhësore për të gjithë punën dhe aktivitetet, si dhe operon në shqip, maqedonisht dhe anglisht.

### **Anëtarësia**

#### **Neni 5**

- (1) Parlamenti Studentor i jep konsideratë të duhur përfaqësimit të gjerë, barazisë dhe ndershmërisë për të siguruar që interesat e të gjithë studentëve janë të përfaqësuara në mënyrë aktive.
- (2) Parlamenti Studentor i UEJL-së përbëhet nga përfaqësues prej secilit nga 5 fakultetet dhe Qendrës së UEJL-së në Shkup, edhe atë, si në vijim:
- 2 përfaqësues nga secili fakultet në studimet deridiplomike në Tetovë;
  - 2 përfaqësues nga studimet deridiplomike, nga Qendra e UEJL-së në Shkup;
  - 1 përfaqësues nga studimet pasdiplomike në Tetovë;
  - 1 përfaqësues nga studimet pasdiplomike nga Qendra e UEJL-së në Shkup;
  - 1 përfaqësues i gjinisë së nën-përfaqësuar apo komunitetit etnik/gjuhësor jo shumicë.
- (3) Nëse ka ndonjë mungesë të përfaqësimit nga cilido nivel, pozita mbetet vakante deri në zgjedhjet e ardhshme.
- (4) Zgjedhjet e Parlamentit Studentor organizohen duke iu përmbajtur Udhëzuesit për zgjedhjet e Parlamentit Studentor.
- (5) Kandidatët, të cilët janë subjekt i masave disiplinore, ose që nuk janë më studentë aktiv nuk kanë të drejtë të kandidojnë.

### **Mandati**

#### **Neni 6**

Mandati i përfaqësuesve të zgjedhur është si në vazhdim:

- Përfaqësuesit zgjidhen, gjatë zgjedhjeve vjetore, në tetor të çdo viti akademik;
- Mandati i përfaqësuesve të Parlamentit Studentor është 1 vit, me të drejtë edhe për një zgjedhje, duke filluar nga 1 dhjetor deri më 30 nëntor të vitit përkatës akademik;

- Mandati i përfaqësuesve të Parlamentit Studentor mund të vazhdojë deri në zgjedhjen e përfaqësuesve të ri të Parlamentit Studentor. Për periudhën deri në zgjedhje të përfaqësuesve të ri të Parlamentit Studentor, përfaqësuesve që ju vazhdohet mandati nuk do të marrin kompensim financiar mujor;
- Përfaqësuesit më së shumti mund të zgjidhen për dy mandate.

### **Udhëheqja e Parlamentit**

#### **Neni 7**

- (1) Udhëheqja e Parlamentit Studentor përbëhet nga:
  - 1 kryetar
  - 1 nënkryetar (Tetovë/Shkup, duke pasur në konsideratë barazinë);
- (2) Pasi të jenë konfirmuar anëtarët e rinj të Parlamentit Studentor, kryetari i Komisionit Zgjedhor e inicion mbledhjen e parë të Parlamentit Studentor dhe e shpall konkursin për pozitën e cekura më lart. Kryetari dhe nënkryetari zgjidhen nga Parlamenti për një mandat 1 vjeçar me të drejtë për tu zgjedhur edhe për një mandat tjetër. Të gjithë zyrtarët duhet të jenë anëtarë aktual të Parlamentit.
- (3) Kryetari dhe nënkryetari vijnë nga kampuset e ndryshme të Universitetit, duke pasur në konsideratë barazinë.
- (4) Parlamenti Studentor cakton një sekretar me mandat prej një viti për të kryer administrimin e mbledhjeve të parlamentit dhe të çështjeve të ngjashme.

### **Përfaqësimi i jashtëm dhe anëtarësimi në organe të tjera**

#### **Neni 8**

Parlamenti Studentor dërgon përfaqësues (jo domosdoshmërisht anëtarë të Parlamentit Studentor), për këto organe të jashtme dhe të Universitetit:

- Konferencën Ndëruniversitare, që përfshinë kryetarin e secilit parlament studentor;
- Parlamentin Studentor Ndëruniversitar;
- Bordin e Universitetit, i përfaqësuar nga kryetari i Parlamentit Studentor.
- Senatin e Universitetit, pesë anëtarë të zgjedhur nga Parlamenti Studentor, me një mandat një vjeçar.
- Drejtorinë Rektoriale, kryetari i Parlamentit Studentor
- Këshilli mësimor-shkencor i fakultetit, një përfaqësues i studentëve për secilën nga tri ciklet e studimit të zgjedhur nga grupi i studentëve të duhur nga fakulteti në fjalë. Mandati i përfaqësuesve të studentëve është 2 vite.
- Këshilli për bashkëpunim dhe besim me publikun - Ekipet e Cilësisë të fakulteteve përkatëse.

### **Avokati i studentëve**

#### **Neni 9**

- (1) Për mbrojtjen e të drejtave të studentëve, nga radhët e studentëve të rregullt të Universitetit, zgjidhet Avokati i studentëve.
- (2) Zgjedhja e Avokatit të studentëve bëhet nga Senati i Universitetit me shumicë të votave të anëtarëve, në bazë të konkursit publik, me propozim të Parlamentit Studentor të

Universitetit, por nga kandidatët jashtë Parlamentit. Konkursi publik shpallet nga Parlamenti Studentor menjëherë pasi të bëhet zgjedhja e organeve të Parlamentit Studentor.

- (3) Mandati i Avokatit të studentëve është dy vite pa të drejtë rizgjedhje.
- (4) Parlamenti Studentor mund të ngrëjë procedurë për shkarkimin e Avokatit të studentit, ndërsa vendimin për shkarkim e miraton Senati i Universitetit, me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

### **Kompetencat e Avokatit të studentëve**

#### **Neni 10**

- (1) Avokati i studentëve vepron për parashtrësë nga ana e studentit, ose me vetiniciativë nëse ka konstatuar se e drejta e studentit është cenuar nga organet e Universitetit ose nga anëtar i stafit të Universitetit.
- (2) Për punën e tij, Avokati i studentëve dorëzon raport vjetor në Senatin e Universitetit.
- (3) Kompetenca, kushtet për zgjedhjen, procedura për zgjedhje dhe shkarkim dhe puna e Avokatit të studentëve përcaktohen me rregullore për punën e Avokatit të studentëve të Universitetit.

### **Komisionet me koordinator që paguhen**

#### **Neni 11**

- (1) Parlamenti Studentor mban të drejtën për të themeluar komisione të përshtatshme për të kryer punën. Ka koordinator që paguhen për fusha të caktuara të punës, të cilat shqyrtohen në baza vjetore. Koordinatorët organizojnë komisione, grupe pune, nën-komisione me një plan vjetor të buxhetit, i cili miratohet nga Parlamenti, më pas operohet dhe vlerësohet.
- (2) Fushat kyçe, të cilat mund të kenë një koordinator që paguhet janë:
  - Informim dhe promovim me nën-komitete për
    - Newsletter
    - Radio
    - Ueb faqe
    - Materiale informative dhe publicitet
  - Punë me komunitetin (mirëqenie të studentëve dhe barazi, bamirësi dhe shërbim për komunitetin)
  - Zbavitje/argëtim (aheng zbavitës, muzikë, ngjarje sociale, aktivitete në mbrëmje për studentët që jetojnë në kampus)
  - Kulturë dhe sport (në bashkëpunim me Përgjegjësin për sport në Universitet, studentët mundet të organizojnë klube të ndryshme)
  - Klubet e studentëve.

## **Klubet e studentëve**

### **Neni 12**

Klubet e studentëve krijohen nga një grup studentësh, që veprojnë në fusha të caktuara përbrenda Universitetit, të cilët janë në interes të studenteve të Universitetit dhe janë në përputhje me parimet e Parlamentit studentor si dhe Universitetit.

Klubet Studentore krijohen me kërkesë nga me së paku 3 studentë, të cilët e bartin përgjegjësinë e mënyrës së udhëheqjes së klubit. Ata duhet të përpilojnë një plan konkret për punën e klubit dhe të njëjtin ta prezantojnë përpara Parlamentit Studentor, i cili me shumicë votash vlerëson nëse pranohet ose nuk pranohet hapja e klubit.

Për financimin e aktiviteteve, klubi bën kërkesë të detajuar të aktivitetit përkatës, të cilën e paraqesin para Parlamentit Studentor, i cili sjell vendim për financimin e të njëjtit.

Klubet mund të shuhen në këto raste:

- Nga vetë anëtarët;
- Nga Parlamenti Studentor, nëse vlerëson se nuk është bërë puna që është premtuar;
- Nga vetë Universiteti, nëse vlerësohet që punon në interesa të kundërta dhe kundër parimeve të Universitetit

## **Koha e punës**

### **Neni 13**

Parlamenti Studentor dhe Avokati i studentëve e publikojnë orarin e punës në bazë vjetore, i cili siguron qasje për 6 ditë pune.

## **Dispozita përfundimtare**

### **Neni 14**

Ky statut hyn në fuqi me 01.12.2019.